



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 21, datë 16.10.2017

PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË PROJEKT GJATË NDËRTIMIT DHE SHTYRJEN E
AFATIT TË LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN
“NDËRTIMI I HIDROCENTRALIT KABASH POROCAN”

Në mbështetje të neneve 27, 28, 40 dhe 48 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 17 dhe 18, të Vendimit Nr. 408, datë 13.05.2015 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozim të shoqërisë “Hec-i Kabash Porocan” sh.p.k, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin e ndryshimeve në projekt gjatë ndërtimit dhe shtyrjen e afatit të Lejes së Ndërtimit për objektin “Ndërtimi i hidrocentralit Kabash - Porocan”, miratuar me Vendimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Komunës Porocan Nr. 2, datë 15.08.2009, me subjekt zhvillues shoqërinë “Hec-i Kabash Porocan” sh.p.k.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave, miratuar me Vendimin e Këshillit të Rregullimit të Territorit të Komunës Porocan Nr. 2, datë 15.08.2009, zëvendësohet me Hartën e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

DAMIAN GJIKNURI



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

